



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT KËSHILLI I BASENIT
UJËMBLEDHËS SHKUMBIN**

VENDIM

Nr.9, datë 27.12.2019

PËR

**MIRATIMIN NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR TË PËRROIT TË
KRASHNËS PËRROIT TË VILANIT DEGË E LUMIT GOSTIMË DEGË KJO E
LUMIT SHKUMBIN PËR PRODHIM HIDROENERGJIE NGA SUBJEKTI " RONC
ENERGIA ALBANIA "SH.PK NËNJËSIN ADMINISTRATIVE POLIS BASHKIA
LIBRAZHD QARKU ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.111/2012, i ndryshuar me ligjin 6/2018, datë 8.2.2018, për "Menaxhimin e integruar të burimeve ujore" V.K.M 221 datë 26.04.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore ", V.K.M Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr 6 datë 12.06.2019 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor.Referuar kodit të procedurës administrative, neni 128, pika 3), "Mjetet ligjore administrative janë: b) rishikimi Neni 144,"Rishikimi, pika 2) parashikon se "Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulon rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen të cilat nuk dihen dhe mund të dihen prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ."Për paisjen me autorizim(miratim në parim) të subjektit "RONC ENERGIA ALBANIA" sh.p.k me propozim të Z.A.B.U. Shkumbin-Seman.

Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin.

V E N D O S I:

- 1- Mos miratimin në parim të burimit ujortë përroit të Krashnës, përroit të Vilanit degë e lumit Gostimë, degë kjo e lumit Shkumbin për prodhim hidroenergjie nga Subjekti " Ronc Energia Albania "sh.pk në Njësinë Administrative Polis Bashkia Librazhd Qarku Elbasan.
- 2- Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin-Seman për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Mos miratimi u vendos pasi Bashkia Librazhd është kundra sepse ky burim ujor i duhet për përdorimin e popullatës.

KRYETARI

MAKSIM MALAJ

